**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Blerina Huruglica** | **15.08.2023** | **25.08.2023** | **2023/0581** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.08.2023, **OE "ARAD 94 " SH.P.K.- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0581**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE ""Konstruktori Ing 1969"& "Flori eng", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i shkolles se mesme ekonomike Isa Boletini**" me nr. të prokurimit: "**615-23-3422-5-1-1**", iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës:

**2,000,000.00 totali**

**200,000.00€ viti 2023**

**1,800,000.00€ viti 2024** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

1. AK ka shkelur Nenin 6 të LPP-së Nr. 04/L-042,

2. AK ka shkelur Nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042,

3. AK ka shkelur Nenin 24 të LPP-së Nr. 04/L-042,

4. AK ka shkelur Nenin 52 të LPP-së Nr. 04/L-042,

5. AK ka shkelur Nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042, 4/17

6. AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042,

7. AK ka shkelur nenin 4 të RRUOPP-së

8. AK ka shkelur nenin 9 të RRUOPP-së

9. AK ka shkelur nenin 39 të RRUOPP-së

10. AK ka shkelur nenin 41 të RRUOPP-së

**Pretendimi 1:** AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk kanë luajtur rol aktiv për t'u siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit për këtë procedurë. Më saktësisht AK pa të drejt ka shpërblyer me kontratë një Grup të OE i cili nuk i plotëson kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Mos aplikimi i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit e shtynë AK-në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 6 të LPP-së por edhe drejt shkeljes së neneve tjera të LPP-së sepse me këtë veprim po tenton të ja besoj kontratën e tillë Grupit të OE i cili nuk është i përgjegjshëm dhe nuk i plotëson një mori të kushteve të parapara nga vet AK-ja. Gjithashtu ne jemi tenderues me çmimin më të ulët dhe komplet i përgjegjshëm andaj kalimi jonë dhe shkuara tek një tenderues me çmim më të lartë se ne konsiderohet shkelje e plotë shfrytzueshmërinë së mjeteve në formën më ekonomike siç e kërkon nenin 6 i LPP-së.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve të cekura në pretendimet tona.

**Pretendimi 2:** AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër shumë mangësive të theksuara në ofertën e tij, Grupi i OE i shpallur fitues favorizohet dhe shpërblehet me kontratë.

Vlen të theksohet se Grupi i OE i shpallur fitues nuk posedon dëshmi të rregullta lidhur me dëshmitë e ofruar për stafin e kërkuar dhe për punët e realizuara në tre vitet e shkuara. Këto dokumente shihen qartë se janë jo të rregullta prandaj trajtimi i tyre si të rregullta nga ana e AK-së konsiderohet favorizim i plotë ndaj këtij OE. Kjo nuk është vetëm favorizim por në një formë është edhe bashkëpunim në manipulim me OE në fjalë që nuk është i përgjegjshëm. Kjo nuk lejohet me asnjë 5/17 nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit andaj shihet hapur se AK ka favorizuar këtë Grup të OE. Detajet e mangësive në ofertën e këtij Grupi të OE do ti shpalosim detalisht në pretendimin 5 ku do ta argumentojmë edhe gabimin dhe shkeljen e AK-së me rastin e shpalljes fitues të një OE të

papërgjegjshëm.

Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë, favorizimin dhe në të njëjtën kohë edhe diskriminimin e tenderuesve.

**Pretendimi 3:** AK ka shkelur nenin 24 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit ka lejuar Zyrtarin Kryesor të Prokurimit të veproj në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë me kontratën e punës dhe ligjin e prokurimit. Sipas pikës 2 të këtij neni, AK është i obliguar të administroj me procedurën e prokurimit në përputhje të plotë me ligjin e prokurimit dhe në të kundërtën duhet të e njoftoj KRPP-në në rast se Zyrtari Kryesor i Prokurimit iu shmanget obligimeve dhe përgjegjësive që ia ka dhënë ligji i Prokurimit Publik. Ja si e përshkruajnë neni 24.2 dhe 24.3 i LPP-së këtë obligim të AK-së:

**24.2** Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.
**24.3** Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është përgjegjës që menjëherë t'i raportojë KRPP-së mbi aktivitetet e prokurimit të autoritetit përkatës kontraktues që ekzekutohen në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.

Bazuar në këtë shihet hapur se AK gjatë administrimit të procedurës dhe gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderuesve, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi administrimin e procedurave të prokurimit vetëm sipas ligjit të prokurimit publik.

**Pretendimi 4:** AK ka shkelur nenin 52 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk i ka respektuara kriteret e vlerësimit të publikuara në dosjen e tenderit. Këtë veprim e ka bërë edhe me rastin e vlerësimit të Grupit të OE të shpallur ftues por edhe gjatë vlerësimit të tenderit tonë. Kjo tregon hapur se AK ka vepruar në kundërshtim me vlerësimin e drejtë të OE ku rrjedhimisht ka shkelur plotësisht edhe nenin 52 të LPP-së.

**Pretendimi 5:** AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të publikuar për këtë qëllim. Pika 4 e këtij neni shumë qarë e thotë se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ky nen konsiderojmë se është shkelur me rastin e vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht të Grupit të OE që e ka shpallur fitues si dhe të tenderit tonë. Në vazhdim po e paraqesim secilën mangësi që Grupi i OE i shpallur fitues e posedon në tenderin e tij si dhe do të argumentojmë që disa nga dëshmitë që AK i ka pranuar si të rregullta, nuk janë sipas ligjit dhe nuk e plotësojnë kushtin e kërkuar nga AK përmes dosjes së tenderit.

Po ashtu do të argumentojmë se i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderi e sidomos ato

për të cilat AK na ka konsiderua të papërgjegjshëm.

- Mungesa e parë tek Grupi i OE të shpallur fitues;

AK kishte kërkuar që OE të posedojnë:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **OE duhet të ketë një ekspert për siguri dhe shëndet në punë, të certifikuar nga MPMS** | **Certifikata e lëshuar nga MPMS, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja për angazhim në këtë projekt.** |
| | | **OE duhet të ketë një ekspert të certifikuar nga AME për mbrojtje dhe zjarri** | **Kopja e certifikatës për zjarrfikës, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrveshja për angazhim në këtë proejkt** |
| | | **OE duhet të ketë një auditor sipas kërkesave të standardit ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2018** | **Dëshmi - Kontrata ose parakontrata e punës, Diplomat ose certifikatat** |

Grupi i OE i shpallur fitues ka mbuluar të tre këto pozita me vetëm një person siç është z. Muhamet Hamiti. Ja dëshmitë:

KONTRAT MBI VEPËR

Me qëllim të implementimit me sukses të projektit:
**Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini** - KOMUNA E PODUJEVES
**Me nr. i Prokurimit: 615-23-3422-5-1-1**
E lidhur në Prishtine më date 18.05.2023 ndërmjet Palëve:

1. **“Konstruktori Ing. 1969”**SH.P.K, me numër të biznesit 810502915 , të cilin e përfaqëson z.Shaip Shabani nga Komunua e Prishtines , (Punëdhenesi); *në njërën anë dhe*

2. Z.**MUHAMET HAMITI** e lindur në Podujeve , me profesion:
**Ekspert I certifikuar nga MPMPS - PER SIGURI DHE SHENDET NE PUNE.**

## KONTRAT MBI VEPËR

Me qëllim të implementimit me sukses të projektit:
**Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini** - KOMUNA E PODUJEVES
**Me nr. i Prokurimit: 615-23-3422-5-1-1**
E lidhur në Prishtine më date 18.05.2023 ndërmjet Palëve:

1. **"Konstruktori Ing. 1969"**SH.P.K, me numër të biznesit 810502915 , të cilin e përfaqëson z.Shaip Shabani nga Komunua e Prishtines , (Punëdhenesi); *në njërën anë dhe*

2. Z.**MUHAMET HAMITI** e lindur në Podujeve , me profesion:
**Ekspert I certifikuar nga AME PER MBROTJE NGA ZJARRI.**

## KONTRAT MBI VEPËR

Me qëllim të implementimit me sukses të projektit:
**Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini** - KOMUNA E PODUJEVES
**Me nr. i Prokurimit: 615-23-3422-5-1-1**
E lidhur në Prishtine më date 18.05.2023 ndërmjet Palëve:

1. **"Konstruktori Ing. 1969"**SH.P.K, me numër të biznesit 810502915 , të cilin e përfaqëson z.Shaip Shabani nga Komunua e Prishtines , (Punëdhenesi); *në njërën anë dhe*

2. Z.**MUHAMET HAMITI** e lindur në Podujeve , me profesion:
**AUDITOR I CERTIFIKUAR**

Bazuar në formën e kërkesës së parashtruar në dosjen e tenderit dhe bazuar edhe në dispozitat ligjore të LPP-së kjo formë e plotësimit të kërkesave të AK-së nuk është e lejuar andaj realisht Grupi i OE ka dështuar plotësimin e dy nga tre kërkesat e paraqitura më lartë dhe si i tillë do duhej konsideruar i papërgjegjshëm. Shto këtu faktin se i njëjti e ka bërë edhe certifikimin e kompanisë për siguri dhe shëndet në punë ku kjo e bënë edhe më të pamundur përdorimin e një personi për mbulim të pozitave në fjalë. Pra nisur nga ligji për konfliktin e interesit, z. Muhamet Hamiti nuk mundet të jetë fare si punëtor i kompanisë në asnjërën nga pozitat për të cilat është paraqitur.

- Mungesa e dytë tek Grupi i OE të shpallur fitues;

Ky grup i OE ka paraqitur lista të projekteve të realizuara në tre vitet e shkuara por nuk ka arritur të dëshmoj me referenca se projektet e tilla janë realizuar në mënyrë të kënaqshme dhe kanë përfunduar. Kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë kështu:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Kapaciteti teknik dheprofesional:**<br>**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare*<br>**Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.** |

Sipas kërkesës së AK shihet se Grupi i OE i shpallur fitues ka dështuar të ia bashkëngjis referencat listave të dorëzuara dhe rrjedhimisht nuk ka arritur të dëshmoj vlerën e projekteve të realizuara prej 3.000.000,00€. Dëshmitë e dorëzuara janë kontrata dhe raporte preliminare që nuk pranohen si referenca të rregullta, ka projekt që është kryer pasi është publikuar njoftimi për kontratë si dhe mungesë të referencave për shumicën e projekteve të paraqitura në listë. Projektet që janë të dëshmuara me referenca të rregullta nuk e arrijnë shumën e projekteve të kërkuara nga AK andaj ky Grup i OE është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm. Dëshmitë për këto i gjeni të bashkangjitura ankesës por i keni edhe tek dosje e tenderit të grupit të OE në fjalë.

Mangësia e tretë e Grupit të OE të shpallur fitues:

Tek Aneks 7 OE: "Konstruktori Ing 1969", nuk posedon dëshmi rreth pajisjes Fiat Hitachi, pasi që në DUD marrësi ose bleresi është "Konstruktori" Podujevë d.m.th. nuk është në pronësi të "Konstruktori Ing 1969". Po ashtu edhe fatura me numër 200103/2000 është lëshuar për N.N.SH.T. "Konstruktori" pra as kjo nuk është në pronësi të "Konstruktori Ing 1969". Mungon miningarkues min. 3T si dhe pozicioni 6 kamion 4AKSA min. 17m3 është vetëm një ndërsa kërkohen dy. -Dhe e fundit por jo më pak e vlefshme në këto pak kohë sa kemi mundur të gjejmë të dhëna pas qasjes në dokumentacion Grupi i OE në fjale ka lidhur marrëveshje me qiradhënës për pajisje të punës me datë 14.04.2023 (njoftimi është shpallur me 24.05.2023) duke përshkruar me titull dhe numër prokurimi projektin në fjalë pa u shpallur ende as njoftimi për kontratë në faqen zyrtare të prokurimit, gjë që paraqet dhe tregon shkelje flagrante të ligjit në Republikën e Kosovës duke na lënë të mendojmë që palët e shpallura fituese janë favorizuar vazhdimisht gjatë këtij procesi dhe shumë proceseve paraprake. Si është e mundur qe OE "Konstruktori Ing. 1969" të bëj marrëveshje dhe të posedoj të dhëna rreth një aktiviteti të prokurimit ende pa u shpallur zyrtarisht në faqen publike zyrtare të prokurimit publike të Kosovës? Të gjitha këto gjetje e bëjnë grupin e operatorëve Pra krejt këto që i theksuam më lart tregojnë se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit si të përgjegjshëm të Grupit të OE që e ka shpallur fitues.

**AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së edh me rastin e eliminimit tonë nga konkurrenca. Arsyetimi i AK-së duket kështu:**

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
*[Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :

1. **Mungon eksperti i sigurisë nga MPMS**
2. **Mungon gjeodeti i diplomuar ose master, keni ofruar nje gjeodet bachelor**
3. **Mungon inxhinieri I hidroteknikës me 5 vite pervoje pune – ju keni ofruar nje inxhinier i ujerave me 3 vite pervoje pune**
4. **Mungon Aneksi 6**
5. **Keni paraqitur nje liste te kontratave dhe kontratat te cilat nuk kane perfunduar akoma, si: Ndertimi I shkolles fillore ne Obranqë vlera 497,715.63€ ; ndertimi I tereneve sportive në Peran – vlera 72,020.24€ (ndertim i ulet) ; ndertimi dhe riparimi i stazes se vrapimit ne FSK – vlera 385,371.4€ (nuk ka perfunduar dhe eshte dnertim I ulet); një kontratë te impiantit për trajtimin e ujërave t6ë zeza me vlerë 2,757,500.38€ e cila është ndërtim I ulët. Si përfundim konsorciumi ka vetëm 2,334,368.21€ vlerë të referencave për ndërtim të lartë**

Pika e parë nuk qëndron sepse ne e kemi paraqitur ekspertin e sigurisë saktë ashtu siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit. Si Ekspert të sigurisë e kemi paraqitur z.Bekim Sadiku, dokumentacionin e të cilit e gjeni tek tenderi jonë ku AK e ka anashkaluar komplet.

Ja dëshmia e licencës ndërsa kontratën dhe dëshmitë tjera i gjeni tek dosje e tenderit:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / Ministrarstvo Rada i Socijalne Zaštite/ Ministry of Labour Social Welfare*

Nr. regjistrit të certifikatës: 51
Br. registarskog certifikata:
No. of registration certificate

**CERTIFIKATË**
PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL NGA FUSHA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË
**POTVRDA**
O POLAGANJU STRUČKOG ISPITA O BEZBEDNOSTI I ZDRAVLJA NA RADU
**CERTIFICATE**
ON PASSED PROFESSIONAL EXAM ON HEALTH AND SAFETY AT WORK

Emri dhe Mbiemri: BEKIM SADIKU
Ime i prezime:
Name and Surname:

Data dhe vendi i lindjes: 16.11.1967
Datum i mesto rođenja:
Date and place of birth:

Pika e dytë nuk qëndron sepse ne e kemi paraqitur si gjeodet të diplomuar – bachelor saktë ashtu siç ishte kërkesa. Ja si e kishte parashtruar AK kërkesën për këtë person:

**Një gjeodet i diplomuar ose master (i licencuar), së paku një vit përvojë pune pas diplomimit.**

Pra me që nuk është kërkuar inxhinier i diplomuar i gjeodezisë por vetëm gjeodet i diplomuar, tregon se edhe Bachelor i gjeodezisë është i pajisur me diplomë që tregon se

është gjeodet i diplomuar. Për këtë pikë e kemi paraqitur z. Burim Halilaj.



REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS NË PRISHTINË

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE IN PRISHTINA

Diplomë Diploma

**BURIM IMER HALILAJ**

U lind më 18.09.1992 në Gllogoc.
U regjistrua në vitin akademik 2012/2013.
Studimet i mbaroi më 8 shtator 2015 në:
DEPARTAMENTI I NDËRTIMTARISË
PROGRAMI STUDIMOR: GJEODEZI
dhe mori titullin:
**BACHELOR I GJEODEZISË**

Born on 18.09.1992 in Gllogoc.
Was enrolled in the academic year 2012/2013.
Completed his/her studies on 8 September 2015 in:
DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING
STUDY PROGRAMME: GEODESY
and was awarded the title:
**BACHELOR OF GEODESY**

Niveli i kualifikimit sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6**
Gjithsej 180 pikë - ECTS
Nota mesatare gjatë studimeve 8.19
Prishtinë, 17 shtator 2015

Level of qualification according to the **National Qualifications Framework: 6**
Total ECTS 180
Average grade of studies 8.19
Prishtina, 17 September 2015

Nr. 1225

Dekani / Dean
Prof. Asoc. Dr. Naser Kabashi

Rektori / Rector
Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu

Pika e tretë nuk qëndron sepse ne e kemi paraqitur për këtë pozitë z.Agim Lajçin i cili posedon përvojën dhe përgatitjen e kërkuar të AK-së. AK këto dëshmi i ka anashkaluar të gjitha dhe pa asnjë të drejtë ligjore na e atribuon si mangësi këtë inxhinier. Të dhënat për të i gjeni tek dokumentet e tenderit të ngarkuara nga Grupi jonë i OE.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Universiteti i Prishtinës
University of Prishtina

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE
DIPLOMA
IN UNIVERSITY EDUCATION
AGIM KAPLLAN LAJÇI
BORN IN PEJA ON 12 OCTOBER 1979
REGISTERED IN THE ACADEMIC YEAR 1998/99
COMPLETED ALL THE REQUIRED EXAMINATIONS
AT THE FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE
DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING
HIDROTECHNIC SECTION
ON 27 APRIL 2006 AND OBTAINED
THE UNIVERSITY TITLE
CIVIL ENGINEERING

Average grade of studies 6.90
Diploma examination grade 9.00

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS
DIPLOMË
E KUALIFIKIMIT UNIVERSITAR
AGIM KAPLLAN LAJÇI
LINDUR NË PEJË MË 12 TETOR 1979
REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 1998/99
MË 27. 04. 2006 I KA DHËNË PROVIMET E PARAPARA
PËR TË MBARUAR FAKULTETIN E
NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS
DEGA NDËRTIMTARI
DREJTIMI HIDROTEKNIK
DHE ME KËTË MERR KUALIFIKIMIN
INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË
Nota mesatare gjatë studimeve 6.90
Nota e provimit të diplomës 9.00
PRISHTINË, MË 20 NËNTOR 2006, NR. 769

Dekani
Prof. Dr. Musa Stavileci

Rektori
Prof. Asc. Enver Hasani

Pika katër nuk qëndron fare sepse ne e kemi dorëzuar Aneksin 6 saktë ashtu siç ishte tek dosja e tenderit. Nisur nga kjo konsiderojmë se AK nuk e ka shikuar fare këtë dokument dhe pa asnjë të drejtë ligjore na e ka atribuar këtë si mangësi. Ja dëshmia:

## Aneksi 6. Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit

**(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)**

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-mail i Blerësit | Numri i telefonit te Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Ndërtimi i Objektit të shkollës në AKSP-ë", Vushtrri | 11/9/2018 | 17.09.2021 | 1,919,797.90 € | AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE | Bekim.dakaj@rks-gov.net | 028/ 590-070 |
| 2 | "Ndërtimi i rrethojës dhe renovimi i objektit të administratës në QMH në Vranidoll" | 10/10/2018 | 28/05/2019 | 68,044.40 € | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | Ilirjana.Reshepi@rks-gov.net | 038-200-19-538 |
| 3 | "Ndërtimi i objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Obrançë" | 15/10/2018 | 13/12/2019 | 87,738.78 € | KOMUNA E PODUJEVËS | prokurimni.podujeva@rks-gov.net | 038/20041022 |
| 4 | "Ndarja dhe rregullimi i hapësirave në objektin e ri të Komunës" | 23/09/2020 | 24/12/2020 | 35,989.30 € | KOMUNA E PODUJEVËS | prokurimni.podujeva@rks-gov.net | 038/20041022 |
| 5 | "Ndërtimi i objektit të shkollës në AKSP" (punë shtesë) | 29/01/2021 | 17.09.2021 | 191,677.42 € | AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE | Bekim.dakaj@rks-gov.net | 028/ 590-070 |
| 6. | "Ndërtimi i terrenit sportiv në fshatin Pernu" | 8/12/2021 | | 72,020.24 € | KOMUNA E PODUJEVËS | prokurimni.podujeva@rks-gov.net | 038/20041022 |
| 7 | "Rregullimi i zyrave të Administratës komunale" | 12/5/2022 | 14/07/2022 | 8,916.67 € | KOMUNA E PODUJEVËS | prokurimni.podujeva@rks-gov.net | 038/20041022 |
| 9 | "Ritender - Ndërtimi dhe riparimi i stazës së vrapimit në Kazermen e FSK-së në Ferizaj" | 1/9/2022 | | 385,371.40 € | MINISTRIA E MBROJTJES | afrim.machusi@rks-gov.net | 03820013500 |

ARAD 94

B17 Dosjea e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur

6

**Aneksi 6. Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit**

**(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)**

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-maili i Blerësit | Numri i telefonit te Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | NDERTIMI I OBJEKTIT AFATRIST KFC DT SHELL | 04.03.2021 | 28.05.2021 | 22,203.74 | AL PETROL SHPK | alkryeziu@live.com | 038 566 665 |
| 2 | NDERTIMI I IMPIANTIT TE TRAJTIMIT TE UJERAVE TE ZEZA NE QYTETIN E GJAKOVES | 10.04.2019 | 30.05.2022 | 2,757,500.38 | KWE | office@k-we.com | 038 777 338 |

**Bashkëngjit:** certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankes dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

**Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik: "CONDOR" SH.P.K.**

**Vula:** 05.06.2023

Sipas kësaj shihet se këtë kriter e kemi plotësuar por AK nuk e ka parë fare duke treguar një mos seriozitet dhe mos përkushtim të madh në kontrollimin e dokumenteve që tenderuesit i kanë paraqitur.

Mangësia e pestë nuk qëndron sepse referenca e kontestuar nga AK duke e cilësuar atë si ndërtim të ulët është e pabazuar. E themi këtë sepse sipas rregullave të ndërtimtarisë, çdo ndërtim me lartësi më të madhe se 60c, pavarësisht në cilin nivel ndodhet konsiderohet ndërtim i lartë. Përpos kësaj çdo here kur kemi të bëjmë me ndërtime që kanë etazhe apo kate siç është objekti i kontratës në fjalë, tregon se kemi të bëjmë me ndërtim të lartë. Lidhur me këtë ne ju kemi siguruar fotografit e ndërtimit të tillë dhe se nga ato shihet hapur se kemi të bëjmë me ndërtim të lartë pavarësisht emërtimit të projektit. Ja si duken ndërtimet e realizuara tek ky projekt.













Pra nga këto foto po shihet se ky projekt i takon plotësisht ndërtimeve të larta dhe në asnjë formë nuk mundet të konsiderohet si projekt i ndërtimit të ulët. E lusim ekspertin shqyrtues që ta konsultoj ndonjë ekspert të degës së ndërtimtarisë për tu bindur me këtë nëse vet eksperti nuk qëllon I profesionit adekuat.

Pra edhe pika e pestë e eliminimit nuk qëndron dhe kur të kalkulohen punët e ndërtimit të lartë dhe të ishtohen projekteve tjera, ne e tejkalojmë vlerën e kërkuar pre 3.000.000.00€ dhe kushti I kërkuar konsiderohet i plotësuar.

Me vet aktin që Grupi i OE që AK e ka shpallur fitues konsiderohet i papërgjegjshëm, del që tenderi do duhej të na jepej neve. Pavarësisht kësaj, me që ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm sipas asaj që e treguam më lartë, dhe gjithashtu e kemi çmimin më të ulët nga tenderuesit e konsideruar të përgjegjshëm, tregohet se po të vlerësonte si duhet AK, tenderi do duhej të na jepej neve. Ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm dhe deklarimet e AK tek

arsyetimi për eliminim janë të pabazuara. Me këtë tregohet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Vlen të theksohet se disa tenderues që kishin çmimin më të ulët se ne, janë të papërgjegjshëm për shkak se nuk kanë arritur të i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit dhe me të drejtë janë eliminuar nga konkurrenca. Kur të merret parasysh që tenderuesit me çmim më të ulët se ne janë të papërgjegjshëm dhe se tenderi jonë i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, vetvetiu kuptohet se fitues i tenderit do duhej shpalleshim ne. Nisur nga kjo kërkojmë nga eksperti shqyrtues që pas trajtimit të të gjitha fakteve dhe dëshmive që ne i kemi paraqitur, pas krahasimit të tyre me dosjen e tenderit dhe pas analizimit të komplet procesit të vlerësimit së bashku me ofertat, të jep rekomandim për panelin shqyrtues që ankesa jonë të cilësohet e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Vërejtje: Tek dispozitat e shkelura kemi përcaktuar edhe disa dispozita tjera që AK i ka shkelur por që të gjitha lidhen me mangësitë dhe trajtimin e gabuar të tenderëve me rastin e vlerësimit. Nisur nga kjo nuk po e përshkruajmë veç e veç por po e paraqesim si pretendim të përgjithshëm se të gjitha dispozitat e cekura AK i ka shkelur gjatë vlerësimit të tenderëve.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdese ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e O**E Grupit të OE “ARAD 94 SH.P.K. & Condor SH.P.K.”** lidhur me tenderin “**Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini**” i iniciuar dhe administruar nga K**OMUNA E PODUJEVËS.**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e **AK - KOMUNA E PODUJEVËS** dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

**Ri-vlerësimi** të bëhet plotësisht bazuar ne kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej **Grupi i OE “ARAD 94 SH.P.K. & Condor SH.P.K.”**

KRITERET PËR VLERËSIM

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Kapaciteti teknik dhe professional:**<br><br>**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare*<br><br>**Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.** |
| | | **Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme**<br>**- Menagjeri i projektit - Inxhinier i dip. ose master i ndërtimtarisë – (drejtimi konstruktiv) me minimumi 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së** | **Lista e stafit profesional dhe e punëtorëve duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Kontrata ose parakontrata valide, cv, diploma (për stafin i cili nuk është në listën e pagave, diplomat dhe parakontratat duhet të jenë të noterizuara), referencat.** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **ngjajshme<br>- Një udhëheqës i punishtes - inxhinier i diplomuar ose ose master i arkitekturës me minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjajshme<br>- Një inxhinier i diplomuar ose master i hidroteknikes, së paku me 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjajshme -<br>Një inxhinier i diplomuar ose master i elektroteknikës, së paku me 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjajshme. Të jetë i certifikuar për efiqiencë të energjisë.<br>- Një inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë, së paku me 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjajshme. - Një gjeodet i diplomuar ose master (i licencuar), së paku një vit përvojë pune pas diplomimit.** | |

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

| |
|---|
| |

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**[1]

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës:** Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i Prokurimit:** | 615 | 2 | 3 | 3 | 4 | 2 | 2 | 5 | 1 | 1 |
| **Nr. i brendshëm** | | | | | | | | | | |

| Nr. | Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës | Vlera totale e ofertave[2] |
|---|---|---|
| 1. | NBT – ING, Shirokë | 3,110,110.51€ |
| 2 | VARNA, Kamenicë | 2,421,803.55 € |
| 3. | Edona, Ferizaj | 2,522,463.04 € |
| 4. | GO: "Kompania Prishtina" & "E Conect" Iot Smart & Green" Prishtinë | 2,644,222.00€ |
| 5. | GO: Konstruktori Ing 1969" & "FLORI eng", Prishtinë | 2,565,696.26 € |
| 6. | GO: "ARAD 94" & " Condor", Prishtinë | 2,482,844.29 € |
| 7. | GO: "Grandelite" & "Meteo" & "QUATRO TRDE" & "HIDRO PROJECT" , Prishtinë | 1,976,948.99 € |
| 8. | 2A Group, Prishtinë | 1,947,744.07 € |
| 9. | Olti Trasing, Prishtinë | 2,276,000.00€ |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

*Komuna e Podujevës* **shpërblen** me kontratë **GO: "Konstruktori Ing 1969" & "FLORI eng" nga Prishtinan** në vlerë të ofertës **2,565,696.26 €**

**Emri dhe mbiemri i ZPP: Ganimete Mahmuti**
**Datë: 26.07.2023**

**B42 - Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar** [7]

**26.07.2023, Podujevë**

**Komuna e Podujevës, rr. ‘Nuhi Gashi”**

**GO: “ARAD 94” & “ Condor”, Prishtinë**

| Nr. i prokurimit: | 615 | 23 | 3 | 4 | 2 | 2 | 5 | 1 | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

**Titulli: Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini**

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP ”

*[Tenderi juaj]* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]* [*dokumentet parakualifikuese]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
*[Tenderi juaj është refuzuar*] për këto arsye :

1. **Mungon eksperti i sigurisë nga MPMS**
2. **Mungon gjeodeti i diplomuar ose master, keni ofruar nje gjeodet bachelor**
3. **Mungon inxhinieri I hidroteknikës me 5 vite pervoje pune – ju keni ofruar nje inxhinier i ujerave me 3 vite pervoje pune**
4. **Mungon Aneksi 6**
5. **Keni paraqitur nje liste te kontratave dhe kontratat te cilat nuk kane perfunduar akoma, si: Ndertimi I shkolles fillore ne Obranqë vlera 497,715.63€ ; ndertimi I tereneve sportive në Peran – vlera 72,020.24€ (ndertim i ulet) ; ndertimi dhe riparimi i stazes se vrapimit ne FSK – vlera 385,371.4€ (nuk ka perfunduar dhe eshte dnertim I ulet); një kontratë te impiantit për trajtimin e ujërave t6ë zeza me vlerë 2,757,500.38€ e cila është ndërtim I ulët. Si përfundim konsorciumi ka vetëm 2,334,368.21€ vlerë të referencave për ndërtim të lartë**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

**Ganimete Mahmuti,**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" ARAD 94 " SH.P.K.**

**Sqarim hyrës:**

Aktiviteti i prokurimit me titull "**Ndertimi i shkolles se mesme ekonomike Isa Boletini**” me nr. të prokurimit: "**615-23-3422-5-1-1**", iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS,** ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 25.04.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 06.06.2023, njoftimi mbi vendimin B58 është publikuar me datë 26.07.2023, ku operatori ekonomik i rekomanduar është **"Konstruktori Ing 1969"& "Flori eng",** gjerësa OE ankuesin e eliminon me arsyetimin**:**

**B42 - Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar** [7]

**26.07.2023, Podujevë**

**Komuna e Podujevës, rr. 'Nuhi Gashi"**

**GO: "ARAD 94" & " Condor", Prishtinë**

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i prokurimit: | 615 | 23 | 3 | 4 | 2 | 2 | 5 | 1 | 1 |

**Titulli: Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini**

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP "
*[Tenderi juaj]* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit*] [*dokumentet parakualifikuese]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

*[Tenderi i juaj]* është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
*[Tenderi juaj është refuzuar*] për këto arsye :

1. **Mungon eksperti i sigurisë nga MPMS**
2. **Mungon gjeodeti i diplomuar ose master, keni ofruar nje gjeodet bachelor**
3. **Mungon inxhinieri I hidroteknikës me 5 vite pervoje pune – ju keni ofruar nje inxhinier i ujerave me 3 vite pervoje pune**
4. **Mungon Aneksi 6**
5. **Keni paraqitur nje liste te kontratave dhe kontratat te cilat nuk kane perfunduar akoma, si: Ndertimi I shkolles fillore ne Obranqë vlera 497,715.63€ ; ndertimi I tereneve sportive në Peran – vlera 72,020.24€ (ndertim i ulet) ; ndertimi dhe riparimi i stazes se vrapimit ne FSK – vlera 385,371.4€ (nuk ka perfunduar dhe eshte dnertim I ulet); një kontratë te impiantit për trajtimin e ujërave t6ë zeza me vlerë 2,757,500.38€ e cila është ndërtim I ulët. Si përfundim konsorciumi ka vetëm 2,334,368.21€ vlerë të referencave për ndërtim të lartë**

